

Data 29.09.2022

AKTI I THEMELIMIT TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“Essence International” SH.P.K.

NENI 1

Themelohet shoqeria tregtare me pergjegjesi te kufizuar **“Essence International” sh.p.k.**, mbeshtetur ne ligjin nr. 9901, date 14.4.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” te ndryshuar, ligjin nr. 9723, date 3.5.2007 “Per Qendren Kombetare te Bizneseve”, ligjin nr. 9121, date 28.7.2003, “Per Mbrojtjen e Konkurrences”, Kodin Civil dhe Kodin e Punes me ortaku themelues si vijon:

Sheng Sun, atësia Guo-Rong, datëlindja 18.06.1983, lindur Kinë dhe banues në Tiranë, mbajtës i dokumentit të identitetit të shtetit të Republikës Popullore të Kinës, Pasaporta me nr. EB908385I.

SELIA E SHOQERISE

NENI 2

Selia e Shoqërisë ndodhet në Qytetin e Tiranës në adresën: Rr. Konferenca e Pezes, ndertesë nr. 163, apartamenti nr. 1/1, Tiranë.

Shoqeria ka te drejte te hapi filiale te tjera brenda territorit te Republikes se Shqiperise ne varesi te selise Qendrore qe ndodhet ne qytetin e Tiranes.

Vendi i mbajtjes se mbledhjeve te asamblese se pergjithshme eshte selia e shoqerise. Nese bihet dakord me unanimitet mbledhjet e asamblese mund te kryhen ne nje vend tjetër.

KOHEZGJATJA E AKTIVITETIT TE SHOQERISE

NENI 3

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e pakufizuar dhe fillon nga momenti i regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit me përjashtim të rasteve kur mbaron sipas parashikimeve në ligj ose kur vendos Asambleja e Pergjithshme.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

NENI 4

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

- - Ofrim i shërbimeve, konsulence këshillime, trajnime dhe zhvillime të projekteve për shoqëritë tregtare të Regjistruara në Republikën e Shqipërisë.

KAPITALI I SHOQERISE

NENI 5

1. Kapitali i shoqërise ka vlerën 100 lekë i cili përbëhet nga 1 kuotë.
2. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Në rast zmadhimi të kapitalit nëpërmjet shtimit të kuotave të reja, ortakët kanë të drejtën e përparësisë në nënshkrim, proporcionalisht me shumën e kuotave të tyre, e drejtë nga e cila ata mund të heqin dorë.
3. Kapitali i shoqërisë, mund të zvogëlohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Zvogëlimi i kapitalit i prek të gjithë ortakët në të njëjtën masë ndaj kuotave të kapitalit që ata përfaqësojnë. Kapitali nuk mund të zvogëlohet nën kufirin minimal që lejon ligji “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

KONTRIBUTET

NENI 6

Kapitali i shoqërisë, zotërohet nga ortaku i vetëm i shoqërisë, Sheng Sun .
Ortaku i vetëm Sheng Sun zotëron 100 % të vlerës së kapitalit;

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

NENI 7

1. Ortakët kanë të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet dhe vendimet e asamblesë së Përgjithshme, dhe ka të drejtën e votës në përpjestim me vlerën nominale të kuotës së tij në kapitalin që ai zotëron.
2. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga bashkëshorti ose një person tjetër i zgjedhur prej tij, me kusht që këta të jenë autorizuar me prokurë (përjashtohet përfaqësimi i një ortaku nga një ortak tjetër apo administratori i shoqërisë).
3. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
4. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
5. Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratorët, ekspertet kontabel të autorizuar, po që se ka të tillë, nga likuiduesit apo ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë. Keta ortake mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës.

Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës. Njoftimi do të bëhet me shkresë, ose nepermjet postes elektronike.

6. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
7. Nëse në kundërshtim me pikën 5 të këtij neni, asambleja e përgjithshme nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë të procedojë sipas ligjit në fuqi "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare":
8. Lajmërimi për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme rregullisht bëhet nga administratorët.
9. Asambleja e Përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme dhe është përgjegjëse për to:
 - a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë; ndryshimet e statutit;
 - b) Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve të shoqërisë;
 - c) Emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) Përcaktimin e shpërblimeve për administratorët, likuiduesit dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - e) Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
 - f) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë. (pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumentacionit perkates);
 - g) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit (pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumentacionit perkates);
 - h) Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - i) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë e në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - j) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - k) Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - l) Çështje të tjera të parashikuara nga ligji.
10. Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

11. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:
 - a) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - b) Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
 - c) Investime;
 - d) Vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
12. Vendimet e parregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.
13. Sipas rëndësisë së vendimeve, mbledhja e asamblesë se pergjithshme mund të jetë e zakonshme ose e jashtëzakonshme.
14. Asambleja pergjithshme vendos me shumice te zakonshme për çështje të tilla si emërimi ose shkarkimi i administratorëve, ekspertëve kontabel të autorizuar dhe likuiduesve, miratimi i raporteve të administrimit dhe të kontrollit, miratimi i pasqyrave financiare vjetore. Asambleja mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 50% te kuotave dhe vendimet merren me me shume se gjysmen e votave te ortakeve pjesemarres.
15. Asambleja e pergjithshme vendos me shumice te kualifikuar për çështje të tilla si ndryshimet e statutit, zvogëlimi dhe zmadhimi i kapitalit themeltar, kalimi tek të tretët, zgjatja e kohës së veprimtarisë së shoqërisë apo likuidimi i saj, shndërimi i shoqërise me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri të formave të tjera, ndarja e fitimeve si dhe cdo çështje tjetër që parashikohet në ligj. Marrja e vendimeve te vlefshme behet vetem nese ortakët qe zoterojne me shume se 70% e kuotave jane te pranishem, votojne me shkrese apo mjete elektronike. Ne kete rast vendimet merren me $\frac{3}{4}$ e votave te ortakeve pjesemarres.
16. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në kete pikë, të këtij neni, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

ADMINISTRIMI

NENI 8

1. Shoqëria administrohet nga nje ose me shume administratorë të cilët janë persona fizike të zgjedhur brenda bashkësisë së ortakëve apo dhe jashtë saj.
2. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, eshte 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje, me përjashtim të rastit të dorëheqjes ose të shkarkimit të parakohshëm para mbarimit të afatit. Shkarkimi i administratorëve nga organi kompetent mund të bëhet në cdo kohë.
3. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

4. Administratorët emërohen dhe shkarkohen me vendim të asamblese se përgjithshme sipas parashikimit në këtë statut.

KOMPETENCAT E ADMINISTRATOREVE

NENI 9

1. Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:
- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
 - c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
 - g) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
2. Administratorët janë të detyruar të thërrasin asamblesë e përgjithshme përsa parashikon ky statut ose ligji.
3. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

EMERIMI I PARE I ADMINISTRATOREVE

NENI 10

Administrator i shoqërisë për periudhën 5-vjeçare do të jetë ortaku i vetëm z. **Sheng Sun**.

EKSPELTE KONTABEL TE AUTORIZUAR

NENI 11

1. Në rast nevojë si dhe kur kërkohet nga ligji, kontrolli financiar dhe aprovimi i llogarive vjetore kryhet nga një ekspert kontabel i autorizuar, i emëruar për dy vite financiare me mundësi rizgjedhjeje nga asambleja e pergjithshme me shumice të zakonshme.
2. Shkarkimi i ekspertit kontabël të autorizuar vendoset në të njëjtat kushte si emërimi i tij, në rast se vërehen gabime, abuzime ose bëhet e pamundur kryerja e detyrës.

E DREJTA E VOTES

NENI 12

Çdo ortak ka të drejta vote në përpjestim me vlerën nominale të kuotës së tij.

E DREJTA PER TE KALUAR REZOLUTE

NENI 13

Asambleja e pergjithshme mund të miratojë rezolute pa plotësuar kriteret e njoftimit në këtë statut apo në ligj. Që të miratohet një rezolute në mbledhjen e asamblese së pergjithshme duhet të jenë të pranishëm të gjithë ortakët personalisht dhe ta votojnë ato në mënyrë të unifikuar.

ZHVILLIMI I SHOQERISE

NENI 14

Shoqëria mund të ndryshojë emërtimin e saj, seline ligjore, objektin, mund të zmadhojë apo të zvogelojë kapitalin themeltar, mund të pranojë ose të largojë ortakë.

MARREDHENIET E PUNES NE SHOQERI

NENI 15

Shoqëria do të përpilojë dokumentet përkatëse për punësimin e personave të tretë duke respektuar dispozitat e Kodit të Punës.

VULA E SHOQERISE

NENI 16

Shoqëria ka vulën e saj në madhësi të zakonshme me tekstin përreth saj.

FITIMI I PERSONALITETIT JURIDIK

NENI 17

Shoqëria do të rregullojë veprimtarinë e saj edhe me Statutin e saj, i cili pasi të nënshkruhet nga ortakët themelues do të fitojë personalitet juridik në ditën e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

BILANCI DHE FITIMI

NENI 18

- 18.1. Viti financiar fillon më datë 1 Janar dhe përfundon më datë 31 Dhjetor të çdo viti.
- 18.2. Llogaritë vjetore, inventari raportet mbi operacionet e viti financiar dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabël, miratohen nga asambleja e përgjithshme e shoqërisë.
- 18.3. Miratimi i dokumenteve mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.

FUNKSIONIMI I SHOQERISE

NENI 19

Rregullat për funksionimin dhe drejtimin e shoqërisë përveç këtij Akti Themelimi janë të percaktuara në Statutin e Shoqërisë.

ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

NENI 20

Te gjitha mosmarreveshjet me organet shtetërore, personat juridike e fizike vendas e të huaj, do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë sipas legjislacionit në fuqi.

DISPOZITA TE TJERA

NENI 21

Ky akt themelimi perpilohet në katër kopje, duke patur secila kopje fuqi të plote ligjore.

Autorizohet, Av. Erion Muka për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortakët themelues të Shoqërisë " **Essence International** " sh.p.k.

THEMELUESI I SHOQËRISË
Essence International
Ortaku i vetëm dhe administrator
Sheng Sun

Sheng Sun